



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1429/22

Gjykata Komeriale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit “...” shpk me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “Sejdiu & Qerkini, ndaj debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, me seli ne Prishtinë”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.193/2021, të datës 26.10.2021, me datë 07.10.2022, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.193/2021, të datës 26.10.2021, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.193/2021, të datës 26.10.2021, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.09/21, i datës 13.01.2021, te lejuar nga Përmbartuesi privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar dhe aktvendimin e ankimuar ta anuloj.

Përgjigje në ankesën e debitorit ka paraqitur kreditori përmes përfaqësuesit Shoqëria e Avokateve “Sejdiu & Qerkini”, duke pretenduar se ankesa e debitorit është e pabazuar dhe me gjendje faktike të gabuar, propozon që ankesa e debitorit te hudhet poshtë si e pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1617/18, të datës 11.12.2018, i formës së prerë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.240/19 të datës 13.10.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 08.01.2021.

Përmbartuesi Privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.09/21 të datës 13.01.2021, e ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor.

Debitori Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 21.01.2021, ka parashtruar prapësim, duke theksuar se aktgjykimi i lartcekur është ne procedurë të ekzekutimit dhe i njëjti do të ekzekutohet brenda dy dite, por që duke parë gjendjen në të cilën po punojnë institucionet (me staf të reduktuar) është vonuar ekzekutimi. Kërkon që urdhri për përmbartim të anulohet ndërsa arsyeton se aktgjykimi ne procedurë do të ekzekutohet.

Përgjigje në prapësim, ka parashtruar kreditori përmes përfaqësuesit Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerikimi”, me datë 27.01.2021, me të cilën ka theksuar se kemi prituri periudhën prej dy dite siç ka kërkuar debitori për ekzekutim dhe se ende nuk është bërë ekzekutimi i mjeteve. Vlerëson se prapësimi i debitorit është i paqëndrueshëm, andaj propozon që Gjykata ta lejoj urdhrin për përmbartim dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.193/21, të datës 26.10.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se përmbartimi është lejuar ne bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1617//18 të datës 11.12.2018, i plotfuqishëm me datën 13.10.2018 dhe i ekzekutueshëm nga data 08.01.2021, është dokument përmbartues dhe si i tillë i plotëson kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 të LPP. Gjykata nuk gjeti prova bindëse ne prapësimin e debitorit me të cilat do të plotësoheshin kushtet për anulim të urdhrin për përmbartim nga neni 71 të LPP, prapësimi i debitorit është i pabazuar pasi nuk mbështetet ne prova të duhura konform nenit 69 par.4 të LPP, andaj edhe vlerëson se nuk ekziston

asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit ashtu që ka vendosur që prapësimin e debitorit ta refuzoj.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1617//18 të datës 11.12.2018, është i formës së prerë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative AA nr.240/2019 dt.13.10.2020, në rastin konkret është dokument përmbarues, konform nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se *“dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbarimor është i përshatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përbushjes së detyrimit”*. Nga del se edhe kjo gjykatë pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se aktgjykimi A.nr.1617//18 të datës 11.12.2018 është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA nr.240/2019 dt.13.10.2020 dhe është i ekzekutueshëm nga data 08.01.2021, dhe përbën titull juridik për përmbarim. Andaj edhe kjo gjykatë nuk ka pranuar pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Sa i përket pretendimit të debitorit se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh rrethanat e krijuara nga pandemia Covid -19 të paraqitura përmes prapësimit, pasi ATK ka punuar në kushte emergjente me staf të reduktuar, kjo gjykatë vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi arsyet e dhëna të debitorit janë vetëm deklarative dhe si të tilla rezultojnë si të pathemelta. Në këtë drejtim Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç kërkohet në nenin 69 par.4 të LPP, andaj nuk janë plotësuar arsyet ligjore nga neni 71 par.1 të LPP për të vendosur ndryshe, dhe nuk ka kushte për anulim të urdhrit përmbarimor.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË  
DHOMA E SHKALLES SE DYTË  
K.DH.SH.II nr.1429/22, me datë 07.10.2022

Gjyqtarja  
Saranda Bogaj-Sheremeti